

20080881651

L I G J **PËR INSPEKSIONIN TEKNIK**

I. Dispozitat e pergjithshme

Neni 1

Me kete ligj rregullohen kompetenca dhe organizimi i Inspeksionit shteteror teknik, menyra e kryerjes së inspeksionit teknik gjate shfrytezimit të pajisjes teknike dhe kushtet të cilat duhet t'i plotesojne personat juridike të pavarur për kryerjen e kontrollimeve teknike dhe kolaudimeve periodike, si dhe menyra e percaktimit të dispozitave teknike për pajisje teknike.

Neni 2

Domethenia e nocioneve në kete ligj:

1. "Pajisje teknike" jane aparatet, makinat dhe instalimet të cilat i nenshtrohen inspeksionit teknik, në pajtim me kete ligj, ndersa dedikohen si mjete për kryerjen e veprimtarise ose si pajisje teknike për perdorim të pergjithshem;

2. "Prodhues" eshte personi fizik ose juridik i regjistruar për kryerjen e veprimtarise në Regjistrin qendror të Republikes së Maqedonise, i cili bën projektimin, konstruktimin, prodhimin, instalimin, ose bashkimin e instalimeve të komplikuara, leshimin në treg, riparimin ose ndryshimin e konsiderueshem, ndersa në raste të caktuara, vë shenjen e perputhshmerise dhe pergatit deklaraten e perputhshmerise;

3. "Shfrytezim" eshte çdo aktivitet i lidhur me pajisjen teknike, që ka të beje edhe me: inspeksionin teknik, leshimin në pune, shkycjen nga puna, rregullimin, programimin, mirembajtjen, servisimin, kontrollimin, masat siguruese në rast të prishjes, ridestinimin, menjanimin, si dhe transportin.

4. "Shfrytezues i pajisjes teknike" eshte personi fizik ose juridik i cili eshte pronar i pajisjes ose merr me qira pajisje për kryerjen e veprimtarise personale, ose paraqitet si punedhenes me pajisjen teknike (në tekstin e metejme: shfrytezues);

5. "Tip i prodhimit" eshte prodhimi për të cilin sigurohet certifikata a tipit në pajtim me dispozitat për sigurimin e prodhimeve;

6. "Venie në perdorim" eshte procedura me të cilen lejohet shfrytezimi i pajisjes teknike;

7. "Inspeksion teknik" eshte kryerja e mbikeqyrjes inspektuese dhe kontrollimi teknik dhe kolaudimeve periodike;

8. "Ndryshim i konsiderueshem i pajisjes teknike" eshte çdo aktivitet i cili ndikon në sigurimin e saj. Si ndryshim i konsiderueshem konsiderohet edhe çdo servisim, mirembajtje ose riparim, të cilat ndikojne në sigurine e pajisjes teknike, dhe

9. "Person juridik i pavarur" eshte personi juridik i cili punet e veta i kryen në menyre të pavarur dhe të paanshme në lidhje me palet e interesuara.

Neni 3

Punet e mbikeqyrjes inspektuese të pajisjes teknike i kryen Inspektorati shteteror për inspektim teknik (në tekstin e metejme: Inpektorati), si organ në perberjen e ministrise kompetente për punet nga sfera e ekonomise (në tekstin e metejme: Ministria).

Neni 4

Punet e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike të pajisjes teknike i kryejne personat juridike të pavarur për kontrollime teknike dhe kolaudime periodike (në tekstin e metejme: personi juridik i pavarur).

II. Kompetencat e Inspektoratit

Neni 5

Inspektorati kryen mbikeqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të ligjeve dhe dispozitave teknike gjate shfrytezimit të pajisjes teknike në fushat në vijim:

- pajisje nën presion;
- ashensore, teleferike, vinca dhe transportues;
- prodhime dhe stabilimente të destinuara për pune në atmosfere eksploduese; dhe
- stabilimente elektroenergjetike, prodhime elektrike dhe aparate dhe
- eksploitim të lendeve të para minerale.

Inspektorati kryen mbikeqyrje inspektuese edhe mbi zbatimin e ligjeve dhe dispozitave tjera gjate kryerjes së gjurmimeve gjeologjike dhe eksploatimit të lendeve të para minerale në pajtim me Ligjin për lendet e para minerale.

Neni 6

Inspektorati mban evidencen e personave juridike të pavarur të cilet i plotesojne kushtet për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimit periodik të percaktuara me kete ligj dhe të njejten e shpall në veb faqen e vet.

Neni 7

Inspektorati miraton aktvendim për venien në perdorim si pajisje teknike për prodhimet të cilat prodhohen në Republikën e Maqedonise, si dhe për pajisjen teknike e cila nuk eshte prodhuar në Republikën e Maqedonise dhe të njejten e evidenton në evidencen perkatese sipas fushes së ciles i takon, në pajtim me nenin 5, paragrafi 1 i ketij ligji.

Çdo tip të produktit të destinuar për leshim në tregun e Republikës së Maqedonise, prodhuesi eshte i detyruar t'ia paraqese Inspektoratit i cili të njejtin e evidenton në evidencen perkatese sipas fushes të ciles i takon, në pajtim me nenin 5, paragrafi 1 i ketij ligji.

Inspektorati mban evidence për kontrollet teknike dhe kolaudimet periodike të pajisjes teknike për të cilen merr vendim për venien në perdorim, si dhe për fatkeqesite e shkaktuara, avarite ose demet e shkaktuara nga pajisja teknike.

Neni 8

Formen dhe permbajtjen e formularit të evidencave nga nenet 6 dhe 7 të ketij ligji, si dhe menyren e mbajtjes së tyre i percakton ministri i Ekonomise.

III. Organizimi i Inspektoratit

Neni 9

Inspektorati punet nga kompetenca e vet i kryen nepermjet të:

- drejtorit të Inspektoratit (në tekstin e metejme: drejtori),
- inspektoreve shteterore për pajisjet nën presion,
- inspektoreve shteterore për ashensore, teleferike, vinca dhe transportues,
- inspektoreve shteterore për prodhime dhe stabilimente që i dedikohen punes në atmosfere eksploduese,
- inspektoreve shteterore për stabilimente elektroenergjetike, prodhime dhe instalime elektrike,
- inspektoreve shteterore për pajisje, prodhime dhe stabilimente që i dedikohen shfrytezimit gjate eksploatimit të lendeve të para minerale,
- inspektoreve shteterore për gjeologji dhe xehetari (në tekstin e metejme: inspektore shteterore), dhe
- të punesuarve tjere në Inspektorat.

Për kryerjen e puneve të caktuara profesionale, administrative dhe ndihmese nga kompetenca e Inspektoratit formohen forma adekuate organizative të brendshme.

Organizimin e brendshëm të Inspektoratit më afer e percakton ministri i Ekonomise me propozimin e drejtorit.

Neni 10

Me punet e Inspektoratit administron drejtori të cilin e emeron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonise, me propozimin e ministrit të Ekonomise.

Drejtor i Inspektoratit mund të emerohet personi i cili ka të kryer arsimin sipëror nga sfera e makinerise, elektroteknikes ose nga sfera tjetër adekuate e lidhur me kompetencat nga neni 5 i këtij neni dhe së paku gjashtë vjet përvojë pune në atë fushë.

Neni 11

Drejtori i administron, organizon, koordinon dhe drejton punet e Inspektoratit.

Drejtori percakton nepunes shtetëror udhëheqës i cili në mungesë të tij e zëvendëson dhe e administron punën rrjedhëse të Inspektoratit.

Drejtori ndermerr masë dhe kujdeset për aftësimin dhe perkryerjen profesionale të inspektoreve shtetërore nga neni 9 i këtij ligji.

Neni 12

Inspektor shtetëror për pajisje nën presion mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga fusha e makinerise dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Inspektor shtetëror për ashensore, teleferike, vinca dhe transportues mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga sfera makinerise ose elektroteknikes dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Inspektor shtetëror për prodhime dhe stabilimente që i dedikohen punës në atmosfere eksplozive mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga sfera e inxhinierise kimike, fizikes ose teknologjise dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Inspektor shtetëror për stabilimente elektroenergjetike, prodhime dhe pajisje elektrike mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga sfera e elektroteknikes dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Inspektor shtetëror për pajisje, prodhime dhe stabilimente që i dedikohen shfrytëzimit gjatë eksploatimit të lendeve të para minerale mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga sfera e xehetarise, makinerise ose elektroteknikes dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Inspektor shtetëror për gjeologji dhe xehetari mund të jetë personi i cili ka kryer arsimin sipëror nga sfera e xehetarise dhe gjeologjise dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Neni 13

Inspektorati i kryen punët në pajtim me programin vjetor të punës.

Në rast të rrezikut të jetës dhe shëndetit të njerezve dhe në situata të cilat kërkojnë intervenim urgjent të organeve shtetërore, Inspektorati mund të ndermarre mbikeqyrje inspektuese jashtë programit vjetor të punës.

Programin vjetor të punës nga paragrafi 1 i këtij neni e miraton drejtori dhe ia dorëzon ministrit të Ekonomise.

Drejtori përgatit raport vjetor për punën e Inspektoratit për vitin paraprak dhe ia dorëzon për praninë përmes ministrise Qeverise së Republikës së Maqedonise, më së voni deri në fund të muajit janar të këtij viti dhe e shpall në veb faqen e vet.

Neni 14

Inspektori shtetëror në mënyrë të pavarur i kryen punët e mbikeqyrjes inspektuese dhe ndermerr masë për të cilat është i autorizuar me këtë dhe me ligj tjetër.

Inspektori shteteror punet e mbikeqyrjes inspektuese i kryen në pajtim me programin vjetor të punes ose me urdheresen e drejtorit, në rastet e percaktuara në nenin 13, paragrafi 2 i ketij ligji.

Neni 15

Inspektori shteteror nuk guxon të kryeje ose të marre pjese në mbikeqyrje inspektuese mbi subjektin e kontrolluar, nese ai ose anetari i familjes së tij eshte pronar ose bashkepronar, anetar i organit administrues ose organit mbikeqyres ose aty ku ai ose anetari i familjes së tij ka interes personal.

Anetar i familjes së inspektorit shteteror nga paragrafi 1 i ketij neni në kuptimin e ketij ligji konsiderohet personi i cili me të eshte në lidhje gjaku në linje të drejte si dhe bashkeshorti/ja i tij/e saj.

Veprimet e ndermarra në kundërshtim me paragrafin 1 të ketij neni jane të pavlefshme dhe konsiderohen si shkelje më e rende e detyres zyrtare.

Neni 16

Autorizimin për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese inspektori shteteror e deshmon me legjitimacion zyrtar.

Inspektori shteteror eshte i detyruar që gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, ta tregojë legjitimacionin zyrtar, ndërsa me kerkesen e subjektit të kontrolluar, të lejojë ta shikojë.

Formen dhe permbajtjen e formularit të legjitimacionit zyrtar, si dhe menyren e dhenies dhe marrjes së legjitimacionit zyrtar nga paragrafi 1 i ketij neni e percakton ministri i Ekonomise.

Neni 17

Inspektoret shteterore e kryejne mbikeqyrjen inspektuese në menyre efikase, efektive dhe transparente, duke mbajtur llogari me kete rast për mbrojtjen e interesit publik dhe deri në shkalle aq sa kjo eshte e mundur për mbrojtjen e interesit të subjektit të kontrolluar.

Neni 18

Personat juridike dhe fizike mund t'i parashtrojne fletëparaqitje Inspektoratit në lidhje me mbikeqyrjen inspektuese nga inspektoret shteterore.

IV. Menyra e percaktimit të dispozitave teknike për pajisje teknike

Neni 19

Ministri i Ekonomise, gjegjesisht ministri në kompetencen e të cilit të percaktuar me ligj jane punet e lidhura me shfrytezimin e pajisjes teknike adekuate miraton dispozita teknike për fushat nga neni 5, paragrafi 1 i ketij neni të cilat vecanerisht permbajne:

- 1) percaktimin e pajisjes teknike e cila eshte objekt i kontrollit teknik dhe kontrollimit periodik;
- 2) percaktimin e aktiviteteve dhe orarin kohor të kontrollit teknik dhe kontrollimit periodik;
- 3) menyren e procedures për kryerjen e kontrollit teknik dhe kontrollimit periodik;
- 4) kushtet më të aferta të cilat duhet t'i plotesojne personat juridike të pavarur;
- 5) menyren dhe proceduren e venies në perdorim të pajisjes teknike, dhe
- 6) llojin e dokumenteve të cilat e percjellin pajisjen teknike gjate venies në perdorim dhe gjate shfrytezimit.

V. Kushtet të cilat duhet t'i plotesojne personat juridike të pavarur

1. Pranimi i aktvendimit për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kontrollimeve periodike

Neni 20

Kontrollet teknike dhe kolaudimet periodike mund t'i kryeje vetem personi juridik me seli në Republikën e Maqedonisë i cili është i regjistruar në Regjistrin tregtar që mbahet në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë për kryerjen e një ose të më shumë veprimtarive nga fushat e percaktuara në nenin 5, paragrafi 1 i këtij ligji si paresore dhe që ka pranuar aktvendim për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike.

Aktvendimin për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrollimeve teknike dhe kolaudimeve periodike nga paragrafi 1 i këtij ligji e miraton ministri i Ekonomisë.

Neni 21

Për konfirmimin e kompetencës, personi juridik është i detyruar të zbatojë procedurën për akreditim në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me dispozitat për akreditim.

Pas marrjes së certifikates për akreditim, personi juridik i parashton kerkese për konfirmimin e plotesimit të kushteve për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike Inspektoratit. Në kerkese theksohet se për cilën nga fushat e nenit 5, paragrafi 1 i këtij ligji, personit juridik kerkon t'i jepet aktvendimi për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike.

Me kerkesen nga paragrafi 2 i këtij neni personi juridik është i detyruar të dorëzojë:

- 1) aktvendimin për regjistrim në regjistrin tregtar;
- 2) deshmine që ka lidhur marreveshje për sigurim nga përgjegjësia e demit nga kryerja e punëve për kontrolle teknike dhe kolaudime periodike;
- 3) deshmine që personi juridik nuk është i gjykuar për veper penale që e bën të papershtatshëm për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- 4) deshmine për bonitet pozitiv, ndërsa për shoqëritë të cilat janë të sapothemeluara deklaraten nga personi përgjegjës te personi juridik që në afat prej gjashtë muajsh duke llogaritur nga dita e leshimit të aktvendimit për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike, do të dorëzojë deshmine për bonitet pozitiv;
- 5) certifikatën për akreditim;
- 6) deshmine për punësimin e kuadrit profesional, dhe
- 7) deshmine që nuk i është kumtuar ndalim për kryerjen e veprimtarisë kontrollime teknike dhe kolaudime periodike të leshuar nga gjykata kompetente.

Nëse kerkesa i përmban deshmite nga paragrafi 3 i këtij neni, Inspektorati e njofton ministrinë për plotesimin e kushteve të personit juridik për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike, në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të kerkeses.

Nëse kerkesa nuk i përmban deshmite nga paragrafi 3 i këtij neni, Inspektorati e therret personin juridik që ta plotesojë kerkesen në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

Nëse personi juridik nuk e ploteson kerkesen me deshmite nga paragrafi 3 i këtij neni në afatin e percaktuar nga paragrafi 4 i këtij neni, ministri i Ekonomisë miraton aktvendim me të cilin e refuzon kerkesen e personit juridik.

Në bazë të njoftimit nga paragrafi 4 i këtij neni, ministri i Ekonomisë në afat prej tete ditësh nga pranimi i njoftimit miraton aktvendim për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike të personit juridik.

Nëse aktvendimi për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike nuk merret në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kerkeses, llogaritet që personi juridik i ploteson kushtet nga nenet 23 dhe 26 të këtij ligji.

Nese personi juridik nuk i ploteson kushtet për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike, ministri i Ekonomise miraton aktvendim me të cilin e refuzon kerkesen e personit juridik.

Kunder aktvendimit nga paragrafet 6, 7 dhe 9 të ketij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykates kompetente.

Neni 22

Aktvendimi për plotesimin e kushteve për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike nuk mund t'i jepet personit juridik nese:

- personat e tij pergjegjes dhe kuadri i tij profesional i punesuar pergjegjes për kryerjen e operacioneve nga procedurat për kontroll teknik dhe kolaudime periodike, jane: projektues, kryeres, furnizues, prodhues ose shfrytezues të pajisjes teknike, as perfaqesues të autorizuar nga cilado pale,

- personi juridik, personat e tij pergjegjes dhe kuadri i tij profesional jane të kycur drejtperdrejte ose si perfaqesues të autorizuar në projektimin, kryerjen, marketingun, ose mirembajtjen e pajisjes teknike të punes, pervec kur behet fjale për kembimin e informatave teknike ndermjet prodhuesit dhe shfrytezuesit dhe personit juridik të pavarur,

- për personat e tij pergjegjes eshte percaktuar ndalim për kryerjen e veprimtarise derisa zgjat ndalimi i percaktuar me vendimin e gjykates, dhe

- në raste tjera kur me ligj eshte caktuar ndalim për kryerjen e veprimtarise derisa zgjat ndalimi i percaktuar me vendimin e gjykates.

2. Personat juridike të pavarur

Neni 23

Personi juridik i pavarur dhe kuadri i tij profesional jane të detyruar t'i kryejne procedurat e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike vazhdimisht me shkallen më të larte të integritetit profesional dhe kompetences teknike dhe të jene të liruar nga të gjitha presionet vecanerisht në menyre financiare, të cilat mund të ndikojne në vleresimin ose në rezultatet nga kontrolltet teknike dhe kolaudimet periodike, vecanerisht nga personat të cilet kane interes nga rezultatet e kontrollit teknik dhe kolaudimet periodike.

Neni 24

Personi juridik i pavarur eshte i detyruar ta siguroje kuadrin e nevojshem profesional që të mund t'i kryeje menyre të rregullt detyrat teknike dhe administrative të lidhura me kontrollin teknik dhe kolaudimet periodike.

Neni 25

Personi juridik i pavarur eshte i detyruar ta kete ose të kete qasje në pajisjen e nevojshme për kontroll teknik dhe kolaudime periodike.

Personi juridik i pavarur eshte i detyruar të rivendos metodologji dhe procedura për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike. Nese personi juridik i pavarur zbaton metodologji dhe procedura specifike, ato duhet të jene teknikisht të qendrueshme dhe në pajtim me arritjet shkencore dhe teknike.

Neni 26

Personi juridik i pavarur eshte i detyruar ta garantoje paanshmerine e kuadrit të vet profesional gjate kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike.

Personi juridik i pavarur eshte i detyruar që çdo vit të sigurohet nga pergjegjesia e demit i cili mund të shkaktohet nga kryerja e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike në lartesi së paku prej 300.000 eurosh me kundervlere në denare sipas kursit të mesem të Bankes Popullore të Republikes së Maqedonise në ditën e pageses.

Personi juridik i pavarur, personat pergjegjes te ai dhe kuadri i tij profesional jane të detyruar ta respektojne besueshmerine profesionale që ka të beje me të gjitha informatat e fituara gjate kryerjes së puneve sipas ketij ligji ose ligji tjetër të lidhur me kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike.

Neni 27

Personat juridike të pavarur jane të detyruar që vazhdimisht t'i plotesojne kushtet nga nenet 23 deri 26 të ketij ligji.

Nese personi juridik i pavarur pushon t'i plotesoje kushtet për kryerjen e kontrollit teknik dhe kontrollimeve periodike, Inspektorati eshte i detyruar që menjehere ta njoftoje ministrine, ndersa më së voni në afat prej tete ditesh nga dita e nderprerjes së kushteve. Në baze të njoftimit, ministri i Ekonomise miraton aktvendim me të cilin shfuqizohet aktvendimi për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike.

Kunder aktvendimit nga paragrafi 2 i ketij neni mund të ngrihet kontest administrativ para gjykates kompetente.

VI. Menyra e kryerjes së inspeksionit teknik

1. Inspeksioni teknik para venies në perdorim

Neni 28

Secili shfrytezues eshte i detyruar mbaje procedure për venien në perdorim të pajisjes teknike në pajtim me dispoziten teknike adekuate për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimit periodik.

Neni 29

Pajisja teknike mund të vihët në perdorim për here të pare ose pas ndryshimit të konsiderueshem nese personi juridik i pavarur ka kryer kontrollin e pare teknik në raport me kushtet e parapara të shfrytezimit dhe atë në raport me:

- montimin,
- instalimin,
- rregullimin dhe
- sigurimin e pajisjes teknike.

Neni 30

Pas zbatimit të kontrollit të pare teknik, varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore, shfrytezuesi Inspektoratit i parashtron kerkese për venien në perdorim të pajisjes teknike menjehere, ndersa më së voni në afat prej tete ditesh nga dita e marrjes së raportit nga kryerja e kontrollit të pajisjes.

Me kerkesen nga paragrafi 1 i ketij neni, shfrytezuesi eshte i detyruar ta parashtroje vecanerisht edhe dokumentacionin në vijim: raportin e kryerjes së kontrollit të pajisjes teknike nga personi juridik i pavarur, deklaraten e vertetuar nga noteri se ka lidhur marreveshje me personin juridik të pavarur i cili do të kryeje kontrollime teknike dhe kolaudime periodike, orarin e kryerjes së kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike dhe dokumentet tjera të percaktuara në dispozitat teknike për çdo fushe të caktuar.

Në baze të kerkeses së parashtruar, Inspektorati bën verifikimin e dokumentacionit të parashtruar nga paragrafi 2 i ketij neni për ta konfirmuar plotesimin e kushteve për venien në perdorim të pajisjes teknike.

Në rastet kur eshte dorezuar dokumentacioni nga paragrafi 2 i ketij neni Inspektorati pas kryerjes së verifikimit, miraton aktvendim për venien në perdorim të pajisjes teknike të shfrytezuesit, në afat prej shtate ditesh nga dita e parashtrimit të kerkeses.

Aktivendimin për venien në përdorim të pajisjes teknike nga paragrafi 4 i këtij neni Inspektorati e evidenton në pajtim me nenin 7, paragrafi 3 i këtij ligji.

2. Inspeksioni teknik gjate shfrytezimit

Neni 31

Shfrytezuesi i pajisjes teknike është përgjegjës për sigurimin e saj dhe për mirëmbajtjen e sigurimit të të njëjtit gjate tere kohes së shfrytezimit të saj.

Shfrytezuesi i pajisjes teknike është i detyruar t'i realizojë aktivitetet sipas orarit të kryerjes së kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike të percaktuara me dispoziten teknike adekuate.

Shfrytezuesi ka të drejtë të bejë zgjedhjen personale të personit juridik të pavarur i cili i paraqet aktivitetet nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 32

Personi juridik i pavarur i cili kryen kontrollin teknik dhe kolaudimet periodike të pajisjes teknike është i detyruar të përgatitë raport i cili do të përmbajë vlerësimin e rezultateve nga kontrollet dhe kolaudimet e zbatuara, dhe të njëjtin t'ia dorëzojë shfrytezuesit, më së voni në afat prej shtate ditësh pas përfundimit të aktivitetëve.

Personi juridik i pavarur vlerësimin e rezultateve nga kontrollet dhe kolaudimet e kryera nga paragrafi 1 i këtij neni e jep në bazë të plotësimit të kushteve për sigurimin e pajisjes teknike.

Neni 33

Raportin nga kontrolli teknik dhe kolaudimet periodike të dorëzuar nga personi juridik i pavarur shfrytezuesit, nëse është e nevojshme varesisht nga pajisja teknike, shfrytezuesi është i detyruar t'ia dorëzojë Inspektoratit në afat prej shtate ditësh nga dita e marrjes së raportit.

Neni 34

Në rast të dallimeve në lidhje me orarin për kryerjen e kontroleve teknike dhe kolaudimeve periodike ndërmjet shfrytezuesit dhe personit juridik të pavarur, si dhe për paraqitjen e dallimeve tjera në lidhje me kontrollet teknike dhe kontrollimet periodike, shfrytezuesi është i detyruar ta njoftojë Inspektoratin.

Në rastin e paragrafit 1 të këtij neni Inspektorati vendos në lidhje me dallimet e paraqitura, në bazë të mendimit të personit tjetër juridik të pavarur, të angazhuar me zgjedhje të rastësishme. Inspektorati për marrjen e rezultateve e njofton shfrytezuesin në afat prej shtate ditësh nga dita e marrjes së rezultateve. Harxhimet për angazhimin e personit tjetër juridik të pavarur bien në barrën e subjektit kundër të cilit është miratuar mendimi.

Neni 35

Nëse raporti nga kontrolli teknik dhe kolaudimet periodike është negativ, shfrytezuesi është i detyruar ta shkyce nga puna pajisjen teknike dhe nëse është e nevojshme varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore, për kete ta njoftojë Inspektoratin.

Për vazhdimin e përdorimit të pajisjes teknike, shfrytezuesi është i detyruar t'i menjanojë shkaqet për raport negativ, të bejë kontroll teknik dhe kolaudime periodike të crregullta dhe nëse është e nevojshme varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore për rezultatet ta njoftojë Inspektoratin.

Neni 36

Nëse rezultati nga kontrolli teknik dhe kolaudimet periodike është negativ, për shkaqe të cilat nuk mund të menjahohen si:

- 1) demtimi i pajisjes teknike riparimi i së ciles ka shkaktuar ndryshim të konsiderueshem,
- 2) degradimi i pakthyeshem i cilesive të pajisjes teknike të cilat e garantojnë sigurinë e saj,

3) nderrimi i lokacionit dhe kushteve të shfrytezimit të pajisjes teknike, dhe

4) nderrimi i destinacionit të pajisjes teknike, inspektori është i detyruar që të marre aktvendim me të cilin do të urdherohet venia jashte perdorimit e pajisjes teknike për të cilen ka marre aktvendim për perdorimin e saj.

Nese shfrytezuesi ka për qellim ta shfrytezoje pajisjen teknike nga paragrafi 1 i ketij neni, pas kryerjes së intervenimeve mbi të, është i detyruar ta zbatoje tere proceduren për inspeksion teknik gjate venies në perdorim.

3. Inspeksioni teknik gjate fatkeqesive, demtimeve ose demeve të shkaktuara nga pajisja teknike

Neni 37

Në rast të fatkeqesive, avarive ose demeve të shkaktuara nga pajisja teknike, shfrytezuesi është i detyruar që menjehere ta njoftoje Inspektoratin.

Inspektorati është i detyruar që në bashkepunim me organet tjera shteterore kompetente të marre pjese në konstatimin e shkaqeve për fatkeqesite, avarite dhe demet e shkaktuara nga paragrafi 1 i ketij neni.

VII. Dispozitat për kundervajtje

Neni 38

Gjobe në shume prej 3.500 deri 5.000 euro me kundervlere në denare do t'i kumtohet për kundervajtje personit juridik nese:

1) çdo lloj prodhimi të destinuar për leshim në treg në Republikën e Maqedonise nuk ia paraqet Inspektoratit, (neni 7, paragrafi 2);

2) nuk zbaton procedure për venien në perdorim të pajisjes teknike në pajtim me dispoziten teknike adekuate për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike (neni 28);

3) pas zbatimit të kontrollit teknik, varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore, shfrytezuesi Inspektoratit nuk ia parashton kerkesen për venien në perdorim të pajisjes teknike menjehere, ndersa më së voni tete dite nga dita e marrjes së raportit nga kryerja e kontrollit të pajisjes (neni 30);

4) nuk i realizon aktivitetet sipas orarit për kryerjen e kontrollit teknik dhe kontrollimet periodike të percaktuar në dispoziten teknike adekuate (neni 31);

5) nuk pergatit raport i cili do të permbaje vleresimin e rezultateve nga zbatimi i kontrolleve dhe kolaudimeve, dhe të njejtin nuk ia dorezon shfrytezuesit më së voni në afat prej shate ditesh pas perfundimit të aktiviteteteve (neni 32, paragrafi 1);

6) në afat prej shtate ditesh nga dita e marrjes së raportit për kryerjen e kontrollit teknik dhe kolaudimeve periodike, ndersa të dorezuar nga personi juridik i pavarur, nese është e nevojshme varesisht nga pajisja teknike, nuk ia dorezon Inspektoratit (neni 33);

7) në rast të dallimeve në lidhje me orarin për kryerjen e kontrolleve teknike dhe kolaudimeve periodike ndermjet shfrytezuesit dhe personit juridik të pavarur, si dhe për dallimet tjera të paraqitura në lidhje me kontrollet teknike dhe kolaudimet periodike, nuk e njofton Inspektoratin (neni 34);

8) raporti nga kontrolli teknik dhe kolaudimet periodike është negativ, ndersa nuk e shkyc nga puna pajisjen teknike dhe nese është e nevojshme varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore për kete nuk e njofton Inspektoratin (neni 35, paragrafi 1);

9) për vazhdimin e perdorimit të pajisjes teknike nuk i menjanon shkaqet për raportin negativ, nuk bën kontroll teknik të crregullt dhe kolaudime periodike dhe nese është e nevojshme varesisht nga dispozita teknike për pajisjen teknike lendore për rezultatet nuk e njofton Inspektoratin (neni 35, paragrafi 2);

10) nuk e zbaton tere proceduren e inspeksionit teknik gjate venies në perdorim (neni 36, paragrafi 2), dhe

11) nuk vepron sipas aktvendimit të inspektoreve shtetërore.

Gjobe në shume prej 1.300 deri 2.000 euro me kundervlere në denare do t'i kumtohet edhe personit pergjegjes te personi juridik për veprimet nga paragrafi 1 i ketij neni.

Gjobe në shume prej 1.300 deri 2.000 euro me kundervlere në denare do t'i kumtohet personit fizik për veprimet nga paragrafi 1 i ketij neni.

Për veprimet nga paragrafi 1 i ketij neni krahas gjobes personit juridik do t'i kumtohet edhe sanksion për kundervajtje ndalim i perkohshem për kryerjen e detyres, në kohezgjatje prej gjashte muajsh deri në pese vjet, ndersa personit pergjegjes te personi juridik do t'i kumtohet sanksion për kundervajtje ndalim për kryerjen e detyrave në lidhje me dispozicionin, shfrytezimin, administrimin dhe perdorimin e pajisjes teknike të punes në kohezgjatje prej një deri në pese vjet.

Inspektoret shtetërore për kundervajtjet nga paragrafi 1, pikat 1, 3, 5, 6 dhe 7 të ketij neni mund t'u kumtojnë denim mandator në vendngjarje personit juridik në shume prej 500 euro me kundervlere në denare, personit pergjegjes te personi juridik në shume prej 200 euro me kundervlere në denare, ndersa personit fizik në shume prej 200 euro me kundervlere në denare.

Për kundervajtjet nga paragrafi 1 i ketij neni eshte kompetente gjykata.

VIII. Dispozitat kalimtare dhe perfundimtare

Neni 39

Personat juridike të cilet kane kryer aktivitete të kontroleve teknike dhe kolaudimeve periodike jane të detyruar ta harmonizojne punen e tyre me dispozitat e ketij ligji deri në ditën e fillimit të zbatimit të ketij ligji.

Neni 40

Dispozitat teknike nga neni 19 i ketij ligji do të miratohen në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Akti nenligjor nga neni 8 dhe neni 16, paragrafi 3 i ketij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 41

Rregullorja për formën dhe permbajtjen e formularit të legjitimacionit të inspektorit shtetëror për inspeksionin teknik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 9/2006) do të pushoje të zbatohet me ditën e hyrjes në fuqi të dispozites nga neni 16, paragrafi 3 i ketij ligji.

Neni 42

Me ditën e fillimit të zbatimit të ketij ligji shfuqizohet Ligji për inspeksionin teknik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 48/99, 82/2005 dhe 79/2007).

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e shpalljes në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndersa do të zbatohet prej 1 tetor 2008.